



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër: 400-01/29974/11, dt. 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 al. 2. pika d) të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28. datë: 04. Qershor 2008"), nenit 3 paragrafi 3.6. të Rregullores Nr. 02/2016 për tituj të nderit, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime dt. 01. Prill 2016, dhe nenit 13 paragrafi 1. pika 1.20. të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 të dt: 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimën e mbajtur me datë: 29 Maj 2025, në propozim të komisionit të kuvendit dhe rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, merr:

VENDIM

Nr. 53/2025

Për dhënien e titullit "Mirënjohje"

SH.B.A. "Gjeravica" 1928

(Shoqatës Bjeshkatore dhe Alpiniste "Gjeravica")

1. SH.B.A. "Gjeravica" 1928, i jepet "Mirënjohje", me motivacion:

"Për kontributin e jashtëzakonshëm në promovimin dhe zhvillimin e qytetit të Pejës në favor të turizmit të qëndrueshëm dhe vlerave natyrore, njerëzore dhe të shtegut kulturor në Komunën e Pejës si një nga organizatat më të vjetra dhe më aktive të llojit të saj në Kosovë. Si lidere në hapjen e shtigjeve malore, në shënimin dhe mirëmbajtjen e tyre, si dhe në vendosjen profesionale të sinjalistikës. Shoqata "Gjeravica" është pjesë e Federatës Bjeshkatore dhe të Ngjitjes Sportive të Kosovës (FBNSK), ku luan një rol të rëndësishëm si kontribuese në strategjitë dhe projektet kombëtare për zhvillimin e bjeshkatarisë."

2. Ky fakt do të evidentohet në regjistrin e veçantë të Qytetarëve të dekoruar nga Komuna e Pejës, të cilin e mban Kuvendi Komunal dhe kryetari i Komunës.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Pejës.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Z. Rexhep Kurtbogaj